



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO  
KOMUNA E SHTIMËS/OPŠTINA SHTIMË

Nr i Profill/ Prof 03111012  
Nr i Faqave/Br.etrana 16  
Data/Dates: 01/04/2025

KOMUNA SHTIME

Drejtoria e Prokurimit

## KONTRATË

Numri i kontratës: 617-25-1148-1-3-6/C811

**Komuna Shtime**, Rr. „Tahir Sinani“, tel. 0290-389-016-228 të cilën e përfaqëson Muhadin Halili Udhëheqës i Zyres së Prokurimit në njëren anë ,

**Dhe**

**MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, PRISHTINË** që e përfaqëson Kastriot Vitija ,tel. 049-159-15-9 , në anën tjetër, janë pajtuar për:

### Blerja e paisjeve speciale mjekësore

Me numër identifikues: 617-25-1148-1-3-6

#### Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë nga Furnizuesi, i furnizimeve në vijim:

**Furnizim me Paisje Speciale Mjekësore për Qendren Kryesore të Mjekësisë Familjare në Shtime**

#### Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë 30 ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të furnizimit do të jetë **QKMF-ja Shtime**

#### Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të originës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

#### Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i furnizimeve duhet të jetë: **7,991.50 € (shtatë/nëntë/nëntë/një/pesë/zero)**

4.2 Çmimi i përmendor në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Furnizuesit sipas kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve.

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

#### Neni 5 Rendi i përparrësisë i dokumenteve të kontratës

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- Kjo marrëveshje e kontratës; PO
- Kushtet e Veçanta të Kontratës;PO
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;PO
- Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknikë;PO

(e) Oferta financiare;PO

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

**Neni 6 Komunikimet**

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues**

Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Udhëheqës i Zyrës së Përkurimit
Nënshkrimi:	
Data:	01.04.2025
Vula:	



**Për Furnizuesin**

Emri:	Kastriot Vitić
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	<i>Vitić</i>
Data:	01.04.2025
Vula:	The logo consists of a stylized green leaf icon to the left of the text "SH.P.K. MatkosPharm PRISHTINE" in blue capital letters.

# KUSHTET E PËRGJITHSHME

Numri i kontratës: 617-25-1148-1-3-6/C811

## Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Produktet" përkufizohen si të mira materiale që kanë vlerë ekonomike, duke përfshirë por pa u kufizuar në mallrat, artikujt, lëndët e para, makineritë dhe pajisjet, objektet në formë të ngurtë të lëngshme ose të gazshme.

1.3 "Autoriteti Kontraktues" do të thotë organizata e blerjes së mallrave, siç është e quajtur Fletën mbi të Dhënat e Tenderit.

1.4 "Furnizues" do të thotë një person fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate furnizon mallra që janë objekti i kësaj kontrate.

1.5 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

1.6 "Inkotermet" do të thotë termat ndërkontakta tregtare që përbëjnë rregullat e interpretimit të termave tregtare që përcaktojnë mënyrën, kostot dhe rreziqet që lidhen me transferimin e produkteve nga furnizuesi tek autoriteti kontraktues.

1.7 "Furnizim" do të thotë dorëzim i produkteve me cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe paketuara në mënyrën e përcaktuar në kontratë.

1.8 "Çmimi i kontratës" do të thotë çmimi që i paguhet furnizuesit siç specifikohet në formularin e kontratës, në përputhje me shtesa të tilla dhe rregullimet ose heqjet, si mund të bëhet në bazë të kontratës.

1.9 "Shërbimet pas shitjes" do të thotë shërbimet ndihmëse, si: instalimi, mirëmbajtja, riparimi i furnizimeve, sigurimi i pjesëve rezervë që i prodhon apo i distribuon furnizuesi dhe/ose detyrime të ngashme në lidhje me furnizimet e produkteve.

1.10 "KPK" do të thotë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.11 "KVK" do të thotë Kushtet e Veçanta të Kontratës.

## Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

## Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Furnizuesi e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Furnizuesi nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Furnizuesit, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Furnizuesit siguruesve të Furnizuesit për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Furnizuesit.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

## Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Furnizuesi ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimt te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Furnizuesi duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Furnizuesin për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njostimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Furnizuesi nuk nënkontraton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përmbrushin kërkasat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideron si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Furnizuesi është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Furnizuesit, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Furnizuesin nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse nënkontraktuesi ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e teikalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Furnizuesit, përkthazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Furnizuesi duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

#### Neni 5 Dhënia e dokumenteve

5.1 Nëse është e nevojshme, brenda 30 ditësh nga nënshkrimi i kontratës, autoriteti kontraktues duhet t'i japë Furnizuesit pa pagesë atëherë kur është e nevojshme, një kopje të skicave të përgatitura për realizimin e kontratës dhe kopje të specifikimeve dhe dokumenteve tjera të kontratës. Furnizuesi mund të blejë kopje tjera të këtyre skicave, specifikimeve dhe dokumenteve tjera, në rast se ato mund të gjenden. Pas lëshimit të certifikatës së garancisë, ose pas pranimit final të saj, Furnizuesi i kthen autoritetit kontraktues të gjitha skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera të kontratës.

5.2 Përveç nëse është e nevojshme për qëllime të kontratës, skicat, specifikimet dhe dokumentet tjera që i jep autoriteti kontraktues nuk duhet të përdoren as nuk duhet t'i komunikohen një pale të tretë nga Furnizuesi pa pajtim paraprak të autoritetit kontraktues.

5.3 Autoriteti kontraktues ka autoritetin për t'i lëshuar Furnizuesit urdhra administrative që inkorporojnë ato dokumente plotësuese dhe udhëzimet që janë të nevojshme për ekzekutim të mirë të kontratës dhe për kompensim dëmi nga ndonjë defekt të saj.

#### Neni 6 Ndihma lidhur me rregulloret vendore

6.1 Furnizuesi mund të kërkojë ndihmën e Autoritetit kontraktues për marjen e kopjeve të ligjeve, rregulloreve dhe informatave mbi zakonet, urdhërët apo ligjet anësore të Republikës se Kosovës të cilat mund të ndikojnë te furnizuesi gjatë realizimit të obligimeve të tij me kontratë. Autoriteti kontraktues mund ta japë ndihmën e kërkuar nga Furnizuesi me shpenzime të Furnizuesit.

6.2 Nëse është e nevojshme, Furnizuesi do ta lajmërojë me kohë Autoritetin kontraktues për të dhënat mbi furnizimet ashtu që Autoriteti kontraktues të mund të marrë lejet e kërkua ose licencat e importit.

6.3 Autoriteti kontraktues do të vendojë që të marrë lejet e kërkua apo licencat e importit brenda një periudhe të arsyeshme, duke marrë parasysh datat e realizimit të kontratës.

#### Neni 7 Obligimet e përgjithshme të Furnizuesit

7.1 Furnizuesi duhet ta realizojë kontratën me kujdesin dhe syçëtësinë e duhur duke përfshirë, aty ku është specifikuar, dizajnin, prodhimin, dorëzimin e furnizimit dhe kryerjen e punëve të tjera përfshirë kompensimin për ndonjë defekt në furnizime.

7.2 Furnizuesi duhet të veprojë sipas urdhreve administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Furnizuesi konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtjetë fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

7.3 Furnizuesi duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

7.4 Furnizuesi duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidencialë. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

7.5 Nëse Furnizuesi është grup, përbëja e grupeve nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit kontraktues.

#### Neni 8 Prejardhja

8.1 Furnizuesi do të paraqesë një certifikatë zyrtare të prejardhjes në momentin e pranimit të përkohshëm. Nëse ky obligim nuk plotësohet, kjo do të çojë në ndërrprerje të kontratës, me paralajmërim zyrtar.

#### Neni 9 Siguria e ekzekutimit

9.1 Furnizuesi do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet

nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e moszekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Furnizuesit.

9.2 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

9.3 Përveç asaj pjesë të specifikuar në KVK lidhur me shërbimin pas-shitjes, siguria e ekzekutimit do të lëshohet brenda 30 ditësh nga lëshimi i certifikatës se perkoħshme të pranimit.

#### Neni 10              **Sigurimi**

10.1 Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet te jene te siguruara plotësisht me një valute lirisht te konvertueshme kundër humbjes ose dëmtimit te rastësishëm te prodhoj ose blejë, transporto, ruaj dhe shpërndaj ne mënyrën e specifikuar ne KVK.

10.2 Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit të Furnizuesit sipas Nenit 10.1, Furnizuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat nga palët e treta pér dëm ndaj pronës ose lëndime personale që shkaktohen nga ekzekutimi i kontratës nga ana e Furnizuesit, nénkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.

#### Neni 11              **Programi i realizimit**

11.1 Nëse kërkohet në KVK, Furnizuesi do të dorëzojë një program të realizimit të kontratës që do të aprovohet nga autoriteti kontraktues. Ky program do të përbajë së paku këto:

- i) rendin sipas të cilil Furnizuesi propozon të realizohet kontrata, duke përfshirë dizajnin, prodhimin, dorëzimin në vend të pranimit, instalimin, testimin dhe komisionimin; dhe
- ii) të dhëna dhe informata të tjera të cilat mund t'i kërkojë me arsyet e autoriteti kontraktues.

11.2 KVK do të saktësojnë limitin kohor brenda të cilil programi i realizimit duhet t'i dorëzohet për aprovim autoriteti kontraktues dhe afatin e fundit për aprovimin e Autoritetit Kontraktues. Aprovimi i programit nga autoriteti kontraktues nuk e liron Furnizuesi nga obligimet e tij sipas kontratës.

11.3 Nëse Autoriteti Kontraktues nuk arrin te njofoj vendimin e tij te aprovimit i përmendur ne Nenin 11.2 brenda afateve te përmendura ne kontratë programi i tillë i realizimit duhet te konsiderohet i aprovuar me kalimin e afateve. Ne qofte se nuk ka afat te caktuar, ato do te konsiderohet te aprovuara 30 dite pas pranimit.

11.4 Asnjë ndryshim material në program nuk mund të bëhet pa aprovimin e autoritetit kontraktues. Megjithatë, nëse progresi i realizimit të kontratës nuk bëhet sipas programit, autoriteti kontraktues mund ta udhëzojë Furnizuesin që ta ripunojë programin dhe ta dorëzojë programin e ripunuar për aprovim te ai.

11.5 Para pranimit të përkohshëm të furnizimeve, Furnizuesi duhet të furnizoj me manualet e funksionimit dhe mirëmbajtjes së bashku me vizatime, të cilat do të janë në detaje të tilla që do të mundësoj Autoritetit Kontraktues operimin, mirëmbajtjen, rregullimin dhe riparimin e të gjitha pjesëve të furnizimeve. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në KVK, manualet dhe vizatimet do të janë në gjuhën e kontratës dhe në forma dhe numrat të tilla të deklaruara në kontratë. Furnizimet nuk do të konsiderohen të përfunduara me qëllim të pranimit të përkohshëm deri sa manualet dhe vizatime e tilla janë furnizuar Autoritetit Kontraktues

#### Neni 12              **Marrëveshjet tatimore dhe doganore**

12.1 Duke iu nënshtruar dispozitave të tjera të përcaktuara në KVK, Furnizuesi do të jetë plotësisht përgjegjës për pagesën e të gjitha taksave, detyrimeve të pullës, taksat e licencave, tarifat doganore dhe taksat tjera që lindin apo imponohen deri në dorëzimin e Mallrave të kontraktuara në vendin e dorëzimit, siç është përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues.

#### Neni 13              **Patentat dhe licencat**

13.1 Përveç në rastet kur është paraparë ndryshe në KVK, Furnizuesi do ta sigurojë autoritetin kontraktues nga të gjitha ankesat që janë rezultat i përdorimit të patentave, licencave, skicave, modeleve ose markave apo emrave tregtarë siç është specifikuar në kontratë, përveç nëse shkelja e tillë është rezultat i veprimit sipas dizajnit ose specifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktues.

#### Neni 14              **Periudha e ekzekutimit të detyrave**

14.1 Periudha e ekzekutimit të detyrave do të fillojë në datën e fiksuar në pajtim me Nenin 2, pa paragjykim ndaj zgjatjeve të periudhës të cilat mund të lejohen sipas Nenit 15.

14.2 Përveç kur palët pajtohen ndryshe, realizimi i kontratës duhet të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Furnizuesi ka të drejtë të mos e realizojë kontratën dhe të marrë përfundimin e saj apo kompensimin pér dëmin që ka pësuar. Furnizuesit do ta humb këtë të drejtë përveç nëse ai e ushtron atë brenda 30 ditëve nga data e skadimit të periudhës 90 ditësh.

14.3 Nëse mundësohen periudhat e ndara të realizimit pér sasi të ndara, këto periudha nuk do të mblidhen në rastet kur një Furnizuesi i jepen më shumë se një sasi.

## Neni 15 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

15.1 Furnizues mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjëren nga këto arsyet:

- Autoriteti kontraktues porosit furnizime ekstra ose plotësuese;
- Kushte të jashtëzakonshme klimatike në vendin e autoritetit kontraktues kanë prekur instalimin apo dorëzimin e furnizimeve;
- Pengesa apo kushte fizike që mund të ndikojnë në dorëzimin e furnizimeve, të cilat nuk kanë mundur të parashihen në mënyrë të mjaftueshme nga një furnizues kompetent;
- Urdhra administrative që kanë ndikuar në datën e realizimit, përvëç atyre që janë shkaktuar prej gabimit të furnizuesit;
- Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- Të gjitha suspendimet e dorëzimit dhe/ose instalimit të furnizimeve që nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit;
- Forca madhore;
- Shkaqe tjera që janë përmendur në këto Kushte të përgjithshme dhe të cilat nuk janë për shkak të gabimit të Furnizuesit.

15.2 Brenda 15 ditësh pasi ka kupltuar se mund të ketë vonesë, Furnizues duhet ta lajmërojë autoritetin kontraktues se ka për qëllim të bëjë kërkesë për zgjatje të periudhës së realizimit për të cilin ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëç nëse ka ndonjë marrëveshje tjetër ndërmjet Furnizuesit dhe autoritetit kontraktues, brenda 30 ditësh i jep autoritetit kontraktues të dhëna gjithëpërfshirëse ashtu që të mund të kontrollohet kërkesa.

15.3 Brenda 30 ditësh, me njoftim me shkrim për furnizuesin, autoriteti kontraktues do ta lejojë këtë zgjatje të periudhës së realizimit nëse mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive ose retrospektive, ose ta informojë Furnizuesin që nuk i është dhënë e drejta për zgjatje të periudhës.

## Neni 16 Vonesat e ekzekutimit

16.1 Nëse Furnizues me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat ose të realizojë shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njofim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

16.2 Nëse mosdorëzimi i mallrave parandalon përdorimin e zakonshëm të furnizimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 16.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të kontratës

16.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së kontratës ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Furnizuesin:

- të konfiskojë garancinë e realizimit;
- të ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Furnizuesi nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhëni e pjesës së mbetur të furnizimeve. Furnizuesi nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Furnizuesi gjithashu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

## Neni 17 Suspendimi

17.1 Autoriteti kontraktues mundet, me urdhër administrativ, në çfarëdo kohe ta udhëzojë Furnizuesin që të pezullojë:

- prodhimin e furnizimeve;
- dorëzimin e furnizimeve në vendin e pranimit në kohën e specifikuar për dorëzim në programin e realizimit ose, nëse nuk është specifikuar koha, në kohën kur ato duhet të dorëzohen; ose
- instalimin e furnizimeve që janë dorëzuar në vendin e pranimit.

17.2 Gjatë pezullimit, Furnizuesi do të mbrojnë dhe sigurojnë furnizimet e vendosura në depon e Furnizuesit ose në ndonjë vend tjetër, nga përkeqësimi, humbja apo dëmtimi për aq sa të jetë e mundur dhe sa është kërkuar nga autoriteti kontraktues, edhe nëse furnizimet janë dorëzuar në vendin e pranimit në pajtim me kontratën, por instalimi i tyre është pezulluar nga autoriteti kontraktues.

17.3 Shpenzimet plotësuese që janë shfaqur në lidhje me këto masa mbrojtëse do t'i shtohen çmimit të kontratës. Furnizuesi nuk do të marrë pagesë të shpenzimeve plotësuese nëse pezullimi është:

- Zgjidhur në mënyrë të ndryshme në kontratë; ose
- është i nevojshëm për arsyet të kushteve të zakonshme klimatike në vendin e pranimit;

- c) është i nevojshëm për shkak të ndonjë gabimi të Furnizuesit; ose
- d) është i nevojshëm për siguri të ekzekutimit të mirë të kontratës ose të ndonjë pjese të saj përderisa nevoja e tillë nuk shkaktohet nga ndonjë veprim apo gabim nga autoriteti kontraktues.

17.4 Furnizues nuk do të ketë të drejtë për shtesa në qmimin e kontratës përvèç nëse ai e lajmëron autoritetin kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit për të pezulluar progresin e dorëzimit se ka për qëllim të bëjë ankesë për ta.

17.5 Autoriteti kontraktues, pas konsultimit me Furnizuesin, do të përcaktojë ato pagesa plotësuese dhe/ose zgjatje të periudhës së realizimit që do të bëhen nga Furnizues përkizazi me këtë ankesë në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme sipas mendimit të autoritetit kontraktues.

17.6 Nëse perjudha e pezullimit i tejkalon 180 ditë, dhe pezullimi nuk është për shkak të gabimit të Furnizuesit, Furnizues, duke njofuar autoritetin kontraktues, mund të kërkojë të vazhdojë me furnizimet brenda 30 ditësh, ose të ndërpresë kontratën.

17.7 Në rastet kur procedura e dhënies ose realizimit të kontratës bëhet e pavlefshme për shkak të gabimeve përbajtjesore, parregullsive ose mashtimit, Autoriteti kontraktues do ta pezullojë realizimin e kontratës. Në rastet kur ato gabime, parregullsi ose mashtime i atribuohen Furnizuesit, atëherë Autoriteti kontraktues mund të refuzojë t'i bëjë pagesat ose mund t'i kthejë shumat që tashmë janë paguar, në proporcion me rëndësinë e gabimeve, parregullsive ose mashtimit.

17.8 Qëllimi i pezullimit të kontratës është që të verifikohet nëse gabimet përbajtjesore të supozuara si dhe parregullsitë apo mashtimet kanë ndodhur në të vërtetë. Nëse ato nuk mund të konfirmohen, realizimi i kontratës do të rifillojë sa më shpejt që është e mundur. Gabimet përbajtjesore ose parregullsitë do të janë të gjitha shkelje të kontratës ose dispozitave rregullative që rezultojnë nga një veprim ose mosveprim që shkakton ose që mund të shkaktojë humbje në buxhetin e Autoritetit Kontraktues.

#### Neni 18 Cilësia e furnizimeve

18.1 Furnizimet duhet t'i plotësojnë specifikimet teknike të paraqitura në kontratë në të gjitha aspektet dhe të janë konform në të gjitha aspektet me skicat, sondazhet, modelet, mostrat, strukturat dhe kërkësat tjera në kontratë, të cilat duhet të mbahen në dispozicion të Autoritetit kontraktues për qëllime identifikimi gjatë periudhës së realizimit të kontratës.

18.2 Të gjitha pranimet teknike preliminare të parapara në KVK duhet të bëhen me kërkësë të dërguar nga furnizuesi i për autoritetin kontraktues. Në kërkësë do të saktësohen materialet, artikujt dhe mostrat e dorëzuar për këtë pranim sipas kontratës dhe të tregojë numrin e sasisë dhe vendin ku do të bëhet pranimi në mënyrën e duhur. Materialet, artikujt dhe mostrat e specifikuara në kërkësë duhet të certifikohen nga autoriteti kontraktues se plotësojnë kërkësat për këtë pranim para se të inkorporohen në furnizime.

18.3 Edhe nëse materialet apo artikujt që do të inkorporohen në furnizime ose në prodhim të komponentëve që do të furnizohen janë pranuar teknikisht në këtë mënyrë, ato prapë mund të refuzohen nëse ndonjë kontrollim tjetër zbulon defekte ose gabime, dhe në këtë rast ato duhet të ndërrohen menjëherë nga furnizuesi. Furnizuesit mund t'i jepet mundësia t'i riparojë dhe t'i përmirësojë materialet dhe artikujt që janë refuzuar, por këto materiale dhe artikuj do të pranohen për inkorporim në furnizime vetëm nëse janë riparuar dhe janë përmirësuar në atë mënyrë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

#### Neni 19 Inspektimi dhe testimi

19. Furnizues do të sigurojë që furnizimet të dorëzohen në vendin e pranimit me kohë që t'i mundësohet autoritetit kontraktues të vazhdojë me pranimin e furnizimeve. Furnizuesi konsiderohet se i ka paraparë plotësisht vështirësitet që mund t'i hasë në këtë aspekt, dhe atij nuk do t'i lejohet që të paraqesë ndonjë arsyë përvonesë.

19.2 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar. Kjo do të bëhet në vendin e prodhimit, fabrikimit, përgatitjes ose në vendin e pranimit apo në vendet që janë specifikuar në KVK.

19.3 Për qëllime të testimeve dhe inspektiveve të tilla, Furnizues do të:

- a) I japë autoritetit kontraktues, përkohësisht dhe pa pagesë, ndihmë, mostra ose pjesë për testim, makina, pajisje, vegla, punë, materiale, skica dhe të dhëna të prodhimit që zakonisht kërkohen për inspektim dhe testim;
- b) Të merret vesh me autoritetin kontraktues për vendin dhe kohën e testimeve;
- c) T'i japë autoritetit kontraktues qasje në çfarëdo kohe të arsyeshme në vendin ku do të realizohen testimet.

19.4 Nëse përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktues nuk është prezent në datën e vendosur për testim, furnizuesi mundet që, përvèç nëse ka martë udhëzim tjetër nga autoriteti kontraktues, të vazhdojë testimin, i cili do të konsiderohet se është bërë në prezencën e autoritetit kontraktues. Furnizuesi menjëherë do t'i dërgojë kopjet e certifikuarë si duhet të rezultateve të testim te Autoriteti kontraktues, nëse nuk ka qenë prezent gjatë testimit, do t'i pranojë rezultatet e testimit.

19.5 Nëse komponentët dhe materialet i kanë kaluar testet e sipërpërmendura, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë furnizuesin ose ta miratojë certifikimin e furnizuesit lidhur me këtë.

19.6 Nëse autoriteti kontraktues dhe Furnizues nuk pajtohen për rezultatet e testimit, secili do t'ia japë tjetrit mendimin e vet

brenda 15 ditësh nga mospajtimi i tillë. Autoriteti kontraktues ose Furnizues mund të kërkojnë që këto teste të përsëriten në të njëjtat kushte dhe rrethana, ose nëse ndonjëra palë kërkon, të testohen nga një ekspert i zgjedhur me marrëveshje të ndërsjellë. Të gjitha raportet e testimit do t'i dorëzohet autoritetit kontraktues, i cili do t'i komunikojë rezultatet e këtyre testeve pa vonesë të furnizuesi. Rezultatet e ri-testimit do të janë përfundimtare. Kostoja e ri-testimit do të bartet nga pala pikëpamja e së cilës dëshmohet se është gabim pas ri-testimit.

19.7 Gjatë realizimit të detyrate të tyre, autoriteti kontraktues dhe personat e autorizuar nga ai nuk do t'i shpalosin personave të paautorizuar informata lidhur me metodat e ndërmarrjes së prodhimit dhe operimit, të cilat informata i kanë marrë gjatë inspektimit dhe testimit.

#### Neni 20 Parimet të përgjithshme të pagesave

20.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës qe duhet t'i behet Furnizues sipas kësaj Kontrate do te specifikohen ne KVK.

20.2 Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Furnizues do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Furnizuesi, i njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

20.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

20.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Furnizuesin që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëherëshëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Furnizues do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

20.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 20.3, Furnizues mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga institucioni lëshues i Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

20.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 20.3 do t'i jasin të drejtë Furnizuesit që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### Neni 21 Dorëzimi

21.1 Furnizuesi duhet t'i dorëzojë furnizimet në pajtim me kushtet e kontratës. Furnizimet do të janë në përgjegjësi të Furnizuesit deri në pranimin e tyre të përkohshëm.

21.2 Furnizuesi do t'i paketojë furnizimet ashtu siç kërkohet për të parandaluar dëmtimin apo keqsimin e gjendjes së tyre gjatë transportit deri në destinacionin e tyre, siç është dhënë në kontratë. Paketimi duhet të jetë i mjaftueshëm për të përballuar pa kufizime, bartjen e ashprën, eksposimin në temperaturë ekstreme, kripën dhe rëniet gjatë tranzitit dhe mbajtjen në ambient të hapur. Madhësia e paketimit dhe pesha duhet t'i përshtaten, nëse është e mundur, largësisë së destinacionit përfundimtar të furnizimeve, dhe mundësisë së mungesës së pajisjeve për bartje të rëndë në të gjitha pikat gjatë transfit.

21.3 Paketimi, shënim i dhe dokumentacioni brenda dhe jashtë pakove duhet t'i janë në pajtim me kërkesat e dhëna në mënyrë të hapur në KVK, dhe i nënshtronënd ndryshimeve që mund të urdhërohen më vonë nga autoriteti kontraktues.

21.4 Asnjë furnizim nuk do të transportohet as të dorëzohet në vendin e pranimit derisa furnizuesi t'i ketë pranuar urdhrin e dorëzimit nga autoriteti kontraktues. Furnizuesi do të jetë përgjegjës për dorëzim në vendin e pranimit të të gjitha furnizimeve dhe pajisjeve të furnizuesit, që janë të nevojshme për qëllime të kontratës.

21.5 Dorëzimi duhet të konsiderohet se është bërë atëherë kur ka dëshmi me shkrim që është në dispozicion për të dy palët se dorëzimi i furnizimeve është bërë në pajtim me kushtet e kontratës.

#### Neni 22 Operacionet e verifikimit

22.1 Furnizimet nuk do të pranohen derisa të janë realizuar verifikimet dhe testet e caktuara me shpenzime të Furnizuesit. Inspektimet dhe testet mund të realizohen para transportit, në pikën e dorëzimit dhe/ose në destinimin final të mallrave.

22.2 Autoriteti kontraktues, gjatë progresit të dorëzimit të furnizimeve dhe para se të merren furnizimet, duhet të ketë fuqinë që të urdhërojë ose të vendosë:

- heqjen nga vendi i pranimit, brenda asaj kohe ose kohësh siç është specifikuar në urdhër, të të gjitha furnizimeve të cilat, sipas mendimit të autoritetit kontraktues, nuk janë në pajtim me kontratën;
- zëvendësimin e tyre me furnizime të mira dhe të përshtatshme;
- heqjen dhe ri-instalimin e mirë të pajisjeve, pa marrë parasysh testet e mëparshme të tyre ose pagesat e pjesshme

të tyre, ose ndonjë instalim që lidhet me materialet, mjeshtérinë ose dizajnin pér tē cilin është përgjegjës furnizuesi, e që sipas mendimit të autoritetit kontraktues nuk është nē pajtim me kontratën;

- d) që puna e bërë ose mallrat e dorëzuar apo materialet e përdorura nga furnizuesi janë ose nuk janë nē pajtim me kontratën, ose që furnizimet apo një pjesë e tyre nuk i plotësojnë kërkesat e kontratës.

22.3 Furnizuesi, sa më shpejt që është e mundur dhe me shpenzime të veta, duhet t'i evitojë defektit e specifikuara. Nëse Furnizuesi nuk vepron sipas këtyre urdhreve, Autoriteti kontraktues do tē ketë tē drejtë tē punësojë persona tjere pér t'i zbatuar urdhrat dhe tē gjitha shpenzimet që janë pasojë e kësaj, apo që do tē shfaqen pér shkak tē kësaj, Autoriteti kontraktues do t'i zbresë nga paratë që do tē paguhen ose tē cilat do tē bëhen obligim pér t'i paguar Furnizuesit.

22.4 Furnizimet që nuk janë tē cilësisë së kërkuar do tē refuzohen. Një shenjë speciale mund t'u vendoset furnizimeve të refuzuara. Shenja nuk duhet tē jetë e atillë që t'i ndryshojë ato, apo tē ndikojë nē vlerën e tyre komerciale. Furnizimet e refuzuara furnizuesi do t'i heqë nga vendi i pranimit, nëse këtë e kërkon autoriteti kontraktues, brenda një periudhe që e saktëson autoriteti kontraktues, dhe nëse kjo nuk realizohet ato do tē hiqen me tē drejtë me shpenzim dhe me trezit të furnizuesit. Të gjitha punët që përfshijnë materialet e refuzuara do tē refuzohen.

### Neni 23 Pranimi i përkohshëm

23.1 Furnizimet do tē merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur tē jenë dorëzuar nē pajtim me kontratën, t'i kenë kaluar nē mënyrë tē kënaqshme testet e kërkuar, dhe tē jenë autorizuar, si dhe tē jetë lëshuar një certifikatë e pranimit tē përkohshëm ose nëse konsiderohet se është lëshuar.

23.2 Furnizuesi mund tē bëjë kërkesë, duke lajmëruar autoritetin kontraktues, pér një certifikatë tē pranimit tē përkohshëm atëherë kur furnizimet tē jenë tē gatshme pér pranim tē përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga pranimi i aplikacionit tē furnizuesit do tē veprojë sipas njërs nga këto më poshtë:

- t'i lëshojë furnizuesit certifikatën e pranimit tē përkohshëm me një kopje pér Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përvèç tjerash, edhe datën nē tē cilën sipas mendimit tē tij janë përfunduar furnizimet nē pajtim me kontratën dhe janë tē gatshme pér pranim tē përkohshëm; ose
- tē refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin tē cilin, sipas mendimit tē tij e kërkon Furnizuesi pér ta lëshuar certifikatën.

23.3 Nëse rrethanat e jashtëzakonshme e bëjnë tē pamundur që tē vazhdohet me pranimin e furnizimeve gjatë periudhës së fiksuar pér pranim tē përkohshëm ose final, autoriteti kontraktues e përgatit një deklaratë pér ta vërtetuar pamundësinë e tillë, nëse është e mundur, nē konsultim me furnizuesin. Certifikata e pranimit ose e refuzimit do tē përgatitet brenda 30 ditësh pas datës nē tē cilën kjo pamundësi pushon së ekzistuari. Furnizuesi nuk do tē nxisë shfaqjen e këtyre rrethanave pér tē evitar obligimin e paraqitjes së furnizimeve nē një gjendje tē përshtatshme pér pranim.

23.4 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose t'i lëshojë certifikatën e pranimit tē përkohshëm ose tē refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej [30] ditësh, ai do tē konsiderohet se ka lëshuar certifikatën nē ditën e fundit tē asaj periudhe, përvèç nē rastet kur certifikata e pranimit tē përkohshëm konsiderohet se përbën certifikatë tē pranimit përfundimtar. Nëse furnizimet ndahen me kontratë nē pjesë, Furnizuesi do tē ketë tē drejtë tē bëjë kërkesë pér certifikatë tē veçantë pér secilën pjesë.

23.5 Në raste tē dorëzimit tē pjesshëm, Autoriteti kontraktues rezervon tē drejtën pér tē dhënë pranim tē pjesshëm e tē përkohshëm.

23.6 Pas pranimit tē përkohshëm tē furnizimeve, Furnizuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më pér përdorim përkufizuar me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do tē heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe tē bëjë ndonjë ndryshim tē gjendjes së vendit tē pranimit siç kërkohen nē kontratë.

### Neni 24 Obligimet pér garanci

24.1 Furnizuesi do tē garantojë që furnizimet tē jenë tē reja, tē papërdorura, tē modeleve tē fundit dhe tē përfshijë tē gjitha përmirësimet e kohëve tē fundit nē dizajn dhe materiale, përvèç nëse kërkohet ndryshe nē kontratë. Furnizuesi do tē garantojë që asnjë nga furnizimet tē mos kenë defekt që shkaktohet nga dizajni, materialet apo mjeshtëria. Kjo garanci do tē mbetet e vlefshme nē atë mënyrë që saktësitet nē KVK.

24.2 Furnizuesi do tē jetë përgjegjës pér mënjanimin e defekteve, ose dëmeve nē ndonjë pjesë tē furnizimeve tē cilat mund tē paraqiten, apo tē ndodhin gjatë periudhës së garancisë dhe tē cilat:

- a) rezultojnë nga përdorimi i materialeve defektive, mjeshtërisë së gabueshme ose dizajnit jo tē mirë nga Furnizuesi; ose
- b) rezultojnë nga veprimet ose mosveprimet e Furnizuesit gjatë periudhës së garancisë; ose
- c) shfaqen gjatë ndonjë inspektimi tē bërë nga Autoriteti kontraktues ose nē emër tē tij.

24.3 Furnizuesi me shpenzime tē veta do ta pëmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt që kjo tē mund tē praktikohet. Periudha e garancisë pér tē gjithë artikujt e ndëruar ose tē riparuar do tē fillojë përsëri nga data nē tē cilën është bërë ndërrimi ose riparimi sipas vlerësimit tē autoritetit kontraktues. periudha e garancisë do tē vazhdohet vetëm pér atë pjesë tē furnizimeve që është ndikuar nga ndërrimi apo riparimi.

24.4 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së garancisë, autoriteti kontraktues do ta lajmërojë k Furnizuesin. Nëse Furnizuesi nuk arrin ta kompensojë dëmin nga ndonjë defekt ose një dëm brenda afatit kohor tē

paraparë në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- të korrigojë defektin apo dëmin vetë, ose të punësojë dikë tjetër për ta bërë punën në rezikun dhe me shpenzimet e Furnizuesit, në të cilin rast kostojë e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga paratë që duhet të paguhen ose garancitë që mbahen prej Furnizuesit ose nga të dy;
- në rast se nuk ka sasi të duhur ose asnjë garanci nuk është efektive kërkoni që të merrni shumën e duhur nga Furnizuesi; ose
- të ndërpresë kontratën.

24.5 Obligimet e mirëmbajtjes do të parashihen në KVK dhe në specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së garancisë nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e garancisë do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

#### Neni 25 Shërbimet pas-shitjes

25.1 Shërbimet pas-shitjes, nëse kërkohen në kontratë, do të jepen në pajtim me të dhënat e parapara në KVK. Furnizuesi do të marrë përsipër të realizojë ose të organizojë realizimin e mirëmbajtjes dhe të riparimit të furnizimeve dhe të sigurojë shpejt pjesët rezervë. KVK mund të saktësojnë që Furnizuesi të sigurojë ndonjë ose të gjitha materialet e mëposhtme, njoftimet dhe dokumentet që kanë të bëjnë me pjesët rezervë që i prodhon apo i distribuon Furnizuesi:

- pjesët rezervë të cilat Autoriteti kontraktues mund të vendsosë t'i blejë nga Furnizuesi, duke kupltuar që ky vendim nuk do ta lirojë Furnizuesin nga obligimet e garancisë sipas kontratës
- në rast të ndërpërjes së prodhimit të pjesëve rezervë, duhet të lajmërohet paraprakisht Autoriteti kontraktues për t'i mundësuar që të blejë pjesët e kërkuar dhe, pas ndërpërjes, skicat, vizatimet dhe specifikimet e pjesëve rezervë, nëse kërkohen dhe kur kërkohen do t'i sigurohen Autoriteti kontraktues pa pagesë.

#### Neni 26 Pranimi përfundimtar

26.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të janë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Furnizuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Furnizuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata finale e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 24 të janë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

26.2 Kontrata nuk do të konsiderohet se është realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit ose derisa të konsiderohet se kjo është nënshkruar nga autoriteti kontraktues.

26.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Furnizuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitive të kontratës.

#### Neni 27 Shkelja e kontratës

27.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

27.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- dëmet; dhe/ose
- ndërpërjen e kontratës.

27.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të janë:

- dëme të përgjithshme; ose
- dëme të likuidueshme.

27.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Furnizuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### Neni 28 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

28.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Furnizuesit 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- kur Furnizuesi në mënyrë përbajtjesore nuk arrin t'i realizojë obligimet e veta sipas kësaj kontrate;
- Furnizuesi dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të punëve;

- c) Furnizuesi refuzon ose është negligjent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- d) Furnizuesi ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- e) Furnizuesi falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykata, ka hyrë në marrëveshje me kreditusit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- f) Furnizuesi është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- g) Furnizuesi është shpallur fajtor për sjellje të rendë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- h) Furnizuesi i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmon interesat financiare të Komuniteteve;
- i) Furnizuesi, pas një procedure tjetër të prokurimit ose procedure të dhënies së një granti të financuar nga buxheti i komunitetit, është deklaruar se ka bërë shkelje serioze të kontratës për mosrealizim të obligimeve të veta kontraktuese;
- j) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Furnizuesit, përvëç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- k) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimin të kontratës;
- l) Furnizuesi nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershmë të kërkuar në kontratë e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

28.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruej ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Furnizuesit. Detyrimi i Furnizuesit për të shtyrë përbushjen duhet të pushojë së ekzistuar menjëherë pas ndërprerjes, pavarësisht nga detyrimet që mund të janë paraqitur tashmë.

28.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Furnizuesin që të ndënmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e furnizimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe përt'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

28.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Furnizuesit ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi furnizimet e dorëzuara dhe punës së realizuar dhe të bëjë rexhistrimin e materialeve të furnizuara dhe të papërdorura. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Furnizuesit dhe parave që i ka borxh Furnizuesit Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

28.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Furnizuesin derisa të janë përfunduar furnizimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi koston ekstra, nëse ka, të furnizimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Furnizuesit para ndërprerjes së kontratës.

28.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërtet kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Furnizuesi humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës të parapara në Nenin 2 të KVK.

## Neni 29 Ndërprerja nga ana e Furnizuesit

29.1 Furnizuesi, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues:

- nuk arrin t'i paguajë Furnizuesit shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit.
- vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- e pëzellon dorëzimin e furnizimeve, ose ndonjë pjesë të tyre, për më tepër se 180 ditë, për arsy që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk mund t'i atribuohen Furnizuesit.

29.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Furnizuesit.

29.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 29.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Furnizuesin për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Furnizuesit.

## Neni 30 Forca madhore

30.1 Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë mosrespektim ose shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një *forcë madhore* që shkaktohet pas datës kur kontrata hyn në fuqi.

30.2 Për qëllime të këtij Neni, termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose

çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngata, vërtëima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngashme e paparashikuar që është përtëj kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

30.3 Pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 16 dhe 28, Furnizuesi nuk do të jetë i detyruar të heqë dorë nga garancia e realizimit, dëmet e likuiduara ose ndërprerja për shkak të shkeljes nëse, dhe deri në atë masë sa, vonesa e tij e realizimit ose mënyrë tjetër dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Gjithashtu, pa marrë parasysh dispozitat e Neneve 20.5 dhe 29, Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nga Furnizuesi për shkelje të kontratës, nëse dne deri në atë masë sa vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

30.4 Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrëthanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrëthanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga autoriteti kontraktues me shkrim, Furnizuesi do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është njoft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mijetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarje e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Furnizuesi nuk do të zbatojë mijete të tillë alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga autoriteti kontraktues

30.5 Nëse Furnizuesi shkakton kosto plotësuese gjatë zbatimit të urdhreve të autoritetit kontraktues ose gjatë përdorimit të mijeteve alternative sipas nenit 30.4 shuma e saj do të certifikohet nga autoriteti kontraktues.

#### Neni 31 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

31.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetren me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e shëh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të janë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetren.

31.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes

#### Neni 32 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

32.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- ose vendim nga gjyqi; ose
- kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK..

32.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## KUSHTET E VEÇANTA


Numri i kontratës: 617-25-1148-1-3-6/C811

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

<i>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</i>		<i>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkates në KPK</i>
<i>Përshtimi i nenit</i>	<i>Nr. Nenit</i>	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiuni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Siguria e ekzekutimit	9.1	N/A
Programi i ekzekutimit	11	<i>Furnizimi i paisjeve ( Liferimi ) duhet të bëhet brenda 30 ditëve nga lëshimi i kërkesës nga AK .</i>
Fillimi dhe përfundimi i kontratës	11.1	Data e Fillimit të fillimit të furnizimeve është 01.04.2025 Data e Përfundimit është 30.06.2025
Cilësia e furnizimeve	18.2	<i>Paisjet duhet të jetë në bazë të specifikave që kërkohet nga institucionet shëndetësore.</i>
Inspektimi dhe testimi	19.2	<i>Menaxheri i kontratës ka autorizim të plotë për inspektimin dhe verifikimin e paisjeve</i>
Pagesa	20.1	<i>Orari i pagesës do të jetë: OE, duhet të sjellë faturen e rregullt.Në faturë duhet të figurojë: Emri i projektit ,nr,i kontratës si dhe nr. i urdhërblerjes ,fatura duhet të jetë e protokoluar , raporti i menaxherit të kontratës për furnizimin e kryer , pastaj bëhet pagesa.</i>
Dorëzimi	21.3	<i>Menaxheri i kontratës , e përcakton mënyrën e paketimit dhe dorëzimit.</i>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	31.2	<i>Çdo mosmarrëveshje eventuale, në mes OE dhe AK , do të zgjidhet me negociata (Marrëveshje)</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	32.1	<i>Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet gjykate në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>

**Specifikacion Blerja e paisjeve speciale mjekësore**


Nr.	Përshkrimi	Njësia matëse	Sasia	Çmimi	Shuma në €
1	<p align="center"><b>Otoskop</b></p> <p>High professional plastic otoscopes with extra bright halogen light provided by fibre optic system. Quality 3 times magnifying movable lens. Output for pneumatic membrane test. Supplied with 7 single-use mini speculum (Ø 2.5 and 4 mm) in a color coördinated nylon bag. All latex free.</p>	copë	5	40	200
2	<p align="center"><b>Pulse-oximeter i gishtit: Portabel aparat Pulse oxymeter</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Determining oxygen saturation (<math>\text{SpO}_2</math>) and heart rate (pulse)</li> <li>• Simple to operate, comfortable measurement. • Lightweight and portable</li> <li>• Dual color OLED display. • 6 different display modes. • 10 adjustable brightness levels</li> <li>• Low battery indication , • Automatic switch-off , With carrying strap</li> <li>• Size: 56 x 31 x 30.5 mm , • Weight: 56g (with batteries), • Batteries: 2 pcs. 1.5V alkaline batteries, size AAA. • Pulse rate measurement range: 30 ~ 250 bpm, • <math>\text{SpO}_2</math> measurement range: 70 ~ 100 %.</li> </ul>	copë	20	9	180
3	<b>Sphygmomanometër me stetoskop dhe manzhetë standarde</b>	copë	50	10	500
4	<b>Heliomata të dörës</b>	copë	4	90	360
5	Turbinë NSK (ose ekvivalent) Specifications: Head Standard Head Turbina Rotation 340,000~410,000 min <sup>-1</sup> Head Size Ø12.1 x H13.3 mm Water Spray Quattro Spray Body Material Stainless,Ceramic Features Bearings / Clean Head System / Push Button Chuck	copë	10	80	800
6	<b>Elektro kauter</b>	copë	1	200	200
7	Mikromotor- WH-RC-20 BC W&H. , without spray,forward / reverse drivespeed: up to 25,000 rpm,without light,standard 4-hole connection (ose ekvivalent) +KUNDERKAND	Copë	2	100	200
8	<b>Çanta per ofrimin e ndihmës së pare ne teren, dhe per vizita mjekësore shqiptale. 40cmx35cm</b>	copë	2	65	130
9	<b>Paravan 3 pjesësh, palues, levizëz</b>	copë	5	70	350
10	<b>Termometer aksillar per matjen e temperaturave tek femijet.</b>	copë	15	1.5	22.5
11	<b>Mbajtese infuzioni me rrrotë</b>	copë	5	60	300
12	<b>Instrument kirurgjik: Pean</b>	copë	10	15	150
13	<b>Instrument kirurgjik: Gjilpermabajtës</b>	copë	10	10	100
14	<b>Gershër të drejtë : perdoren për prerjen e suturave</b>	copë	10	10	100
15	<b>Gershër të medha për prerjen e materialit (gazes)</b>	copë	10	10	100
16	<b>Mandreni (tel) per Tubusat te Intubimit per femije dhe te erritur (6mm,3.5mm).</b>	copë	10	9 SH.P.K 90	90




	<b>Monitor per matjen e shenjave vitale Patient Monitor Meditech MD9012</b> - Parametrat standardë: EKG, frymëmarrje, PR, NIBP, SpO2, TEMP, - Dalje VGA përmundësi lindjeje me ekran të jashtëm - Ekran sinkron maksimumi 8 kanalesh - Me bateri litium të rikarikueshme - Tre module punë monitorimi, operimi dhe diagnostikimi - Analiza e arritmisë dhe analiza e segmentit S-T - I përshtatshëm për pacientët e rritur, pediatrikë dhe neonatal - Maksimumi 720 orë trendë grafike dhe tabelare, - Ruajtja e deri në 10000 regjistrime NIBP - Monitorim wireless i disponueshem - Ekran me rezolucion të lartë 12,1"				
17	<b>sterilizator 18L</b>	copë	1	300.	300
19	<b>Set për intubim</b>	copë	3	24.	72
20	<b>Rregulator per bombola të oksigjenit</b>	copë	7	35	245
21	<b>Shiring per pastrimin e yshëve (Qelq)</b>	copë	2	70	140
22	Inhalator profesional per inhalim tek femijet dhe të rriturit. Te Përbajt maskën për të rritur dhe per femije, pajisjet per hunden dhe gojen, filtrin, dhomezen, tubin dhe manuallin e përdorimit.	copë	8	19	152
23	<b>Aspirator elektrik per aspirim nasal, oral dhe tracheal.</b> Operating voltage: 220-230 V / 50-60 Hz 110 V - 60 Hz (on request) Power consumption: 184 VA Bottle capacity: 1000 ml Flow (air litres/min): 16 l/min Max suction: -0.75 bar (563 mmHg) Operating cycle: continuous Noise level: 60.5 dBA Size: 35 x 21 x 18 cm Weight: 2.5 kg Norms: 93/42/ECC	copë	2	150	300



	<p><b>EKG/Electrocardiograph:</b>  <b>Aparat me 12 kanale Electrocardiograf-ECG-</b>  <b>Floating input circuit protects against defibrillator effect.</b></p> <p><b>12-Leads Lead Standard</b>  <b>frequency response 0.05Hz - 150Hz (-3dB)</b>  <b>&gt;3.2 seconds Time Constant</b>  <b>&gt;60dB, 100dB CMRR</b>  <b>Input Impedance 50MΩ</b></p> <p><b>25-35Hz EMG Interference Filter (-3dB)</b>  <b>Thermal Printing System for Recording</b>  <b>Patient Current Leakage 10µA</b></p> <p><b>Recording paper specifications: 210mm x 30m roll paper, high speed paper</b></p> <p><b>Auto record speeds are 25mm/s and 50mm/s, respectively, with a 5% error margin.</b></p> <p><b>Paper speed Auto record: 25mm/s, 50mm/s, error ± 5%</b>  <b>Rhythm record: 25mm/s, 50mm/s, error ± 5%</b>  <b>Manual record: 5mm/s, 6.25mm/s, 10mm/s, 12.5mm/s, 25mm/s, 50mm/s, error ± 5%.</b></p> <p><b>Recording configuration according to auto record format and mode, changing leads automatically, measuring and analyzing</b>  <b>Sensitivity options include 2.5, 5, 10, 20, and 40 mm/mV, with a 5% inaccuracy, 10mm/mV 0.2mm/mV is the standard sensitivity.</b>  <b>Rhythm Record Setup according to the format and mode of the rhythm record, automatically measuring and analyzing</b>  <b>Recording according to a manual record format and manually changing leads</b></p> <p><b>Measurement parameters HR, P-R interval, P Duration, QRS Duration, T Duration, Q-T interval, Q-Tc, P axis, QRS Axis, T Axis R(V5), S(V1), R(V5) + S(V1)</b></p> <p><b>There is a defibrillation and pacing protection circuit in the Product Safety Type Class I CE applied portion.</b></p> <p><b>Noise Level &lt;15µVp-p</b>  <b>Size 334mm(L) x 320mm (W) x 85mm (H)</b>  <b>Enduring Polarization voltage ±500mV</b>  <b>Power Supply AC AC:100-240V, 50/60 Hz DC: 14.8V, 3700 mAh rechargeable lithium battery</b></p>			copë	2	900.	1800
24.							Gjithesj: 7991.50

Emri i Kompanisë	MATKOS PHARM SHPK.
Adresa e Plotë	SAMI FRASHERI
Përfaqësuar Nga:	
Emri & Mbiemri	SH. P. A. KASTRIOT VITIA DIRECTOR
Pozita	
Nënshkrimi:	
Data	27.02.2025
Vula	MatkosPharm

1. Menvele Hësëni Smogli -   
2. Lumhie Aliu -   
3. Anbenita Frangj Maligj - 



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**  
**KOMUNA SHTIME**  
**OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME**



**Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi  
Uprava za Urbanizam, Katastar i Geodeziju  
Department of Urban Planning, Cadastre and Geodesy**

Data/Datum/Date:	03/04/2025
Nr./Br./No	06/28
Për/Za/To:	Drejtori i Prokurimit
Nga/Od/From:	Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi Drejtori, GREJTALB EMINI
Lënda/Predmet/Subject :	Menaxheri i kontrates dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Kontratës

Në bazë të nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Lgjin Nr. 05/L-068 dhe Lgjin Nr. 05/L-092, nenit 9 paragrafi 1 pika g), si dhe nenit 61 te Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe Vendimit të ZKA nr. 02/70, të datës 25.03.2022 për autorizim për emërimin e menaxherëve dhe mbikëqyrësve të kontratave. Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi merr këtë:

**VENDIM**

- Emërohet Menaxheri i kontrates dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Kontratës për konratën;
- “Blerja e palsjeve speciale mjekësore” për Komunën e Shtimes -Kontratë korrinë për 24 muaj”Ri tenderim”
- Menaxher i Kontratës: z.Herolin Selmani

Neni 70 Bartja e përgjegjësisë te Menaxheri i Kontratës:

70.11 Plani për menaxhimin e kontratës do të përgatitet para fillimit të zbatimit të kontratës dhe me pajtimin e palëve të kontratës jo më vonë se pesë (5) ditë pune pas nënshkrimit të kontratës. Palët e kontratës, përkatësisht Menaxheri i Kontratës nga ana e AK dhe Menaxheri i Kontratës nga ana e OE duhet të pajtohen përfundimisht dhe obligimet e përcaktuara në planin për menaxhimin e kontratës në pajtim me kushtet e kontratës, dokumentohet me nënshkrimin e palëve, si dhe aprosimin e palëve në platformën e e-prokurimit.

70.24 Funksionet e menaxherit të Projektit/kontratës janë: I. Të lëshojë Certifikatat e nënshkruara për dorëzimet (Certifikatën e përkohshme/të përhershme).

- Emërohet Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës: z.ILAZ KADRIJAJ
- Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës:  
Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës është përgjegjës për Shqyrtimin, aprosimin dhe procesimin e vlerësimit të përfomancës së kontraktuesve të plotësuar platformën e eprokurimit nga menaxherët e kontratave nën mbikëqyrjen e tij/saj.



6. Menaxheri i kontratës, dhe Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratave në pajtim me Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, si dhe Manualet për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës;

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

I'u dorëzohet:

1. Menaxherit të Kontratës;
2. Mbikëqyrësit të Menaxherit të Kontratës;
3. Zyrës se Kryetarit;
4. Drejtorisë së Prokurimit.